



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA EZHVILLIMIT EKONOMIK/ MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA/ MINISTRY OF ECONOMIC
DEVELOPMENT

Privatizimi i Distribucionit dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike të Kosovës

MARRËVESHJE PËR FURNIZIM ME SHUMICË

Tetor 2012

Përmbajtja

1.	Marrëveshja	2
2.	Përkufizimet.....	2
3.	Fillimi dhe skadimi	2
4.	Data e hyrjes në Fuqi	3
5.	Shitja dhe blerja e energjisë elektrike	3
6.	Tarifa.....	5
7.	Pagesat	5
8.	Kodi i Rrjetit, Kodi i Njehsimit dhe Kyçja në Sistem	6
9.	E pashfrytëzuar.	6
10.	Fuqia Madhore	6
11.	Përgjegjësitë dhe dëmshpërblimet	8
12.	Shkëputja	8
13.	Ndarja.....	9
14.	Variacionet.....	10
15.	Zotimet dhe garancitë	10
16.	Konfidencialiteti dhe publiciteti.....	12
17.	Delegimi, transferet e interesit	12
18.	Njoftimet.....	12
19.	Tërësia e marrëveshjes.....	13
20.	Heqja dorë.....	13
21.	Pasardhësit	13
22.	Marrëdhëniet e palëve.....	13
23.	Mirëbesimi	13
24.	Siguri të mëtejme	14
25.	Imuniteti sovran	14
26.	Kostot.....	14
27.	Kopjet.....	14
28.	Zgjidhja e kontesteve dhe ligji i zbatueshëm	14
SHTOJCA 1		19
Pjesa 1		19
PËRKUFIZIMET.....		19
SHTOJCA 2		
Pjesa 1		
Sikur në datën e kësaj Marrëveshjeje, konsumatorët e privilegjuar kanë kuptimin siç definohet në Ligjin për Energji të vitit 2010, neni 19.4		24
Pjesa 2		
Pikat e interkoneksionit.....		24

Kjo Marrëveshje është lidhur më 17 Tetor, të vitit 2012, nga palët në vijim:

(1) **Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.**, shoqëri aksionare e themeluar në Kosovë, me numër të regjistrimit të Biznesit 70325399, me seli të regjistruar në Rrugën Nëna Terezë, Nr. 36, në Prishtinë, Kosovë (në tekstin e mëtejme 'KEK'); dhe

(2) **Kompania Kosovare Për Distribuum Dhe Furnizim Me Energji Elektrike sh.a.**, shoqëri aksionare e themeluar në Kosovë, me numër të regjistrimit të biznesit 70606119, me seli të regjistruar në Zyrën Nr.3 Bulevardi Bill Clinton, Prishtinë, Republika e Kosovës (në tekstin e mëtejme 'KEDS').

Të cilave në njëjës ju referohet me 'Pala' ndërsa në shumës 'Palët'.

1. Marrëveshja

1.1 Në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe duke iu nënshtruar atyre, KEK pajtohet të furnizojë dhe KEDS pajtohet të pranojë dhe blejë energjinë elektrike.

2. Përkufizimet

2.1 Termet e përkufizuara në këtë Marrëveshje do t'i kenë kuptimet të cilat u janë përcaktuar në Pjesën 1 të Shtojcës 1.

2.2 Disa rregulla të caktuara të interpretimit të cilat zbatohen në këtë Marrëveshje janë përcaktuar në Pjesën 2 të Shtojcës 1.

3. Fillimi dhe skadimi

3.1 Në datën e lidhjes së kësaj marrëveshjeje, do të hyjnë në fuqi dhe do të kenë efekt dispozitat në vijim:

- (a) Nenet 3.2 dhe 3.3;
- (b) Nenet 4.2 dhe 4.3 (Njoftimi dhe Data e Hyrjes në Fuqi);
- (c) Neni 5.4 (Deklaratat e Disponueshmërisë);
- (d) Neni 5.9 (Nominimet);
- (e) Neni 10 (Fuqia Madhore);
- (f) Neni 11 (Përgjegjësitë dhe Dëmshpërblimet);
- (g) Neni 12 (Shkëputja);
- (h) Neni 16 (Konfidencialiteti);
- (i) Neni 18 (Njoftimet): dhe
- (j) Neni 28 (Zgjidhja e Kontesteve dhe Ligji i Zbatueshëm).

3.2 Nga dita e Hyrjes në Fuqi dispozitat e mbetura të kësaj Marrëveshjeje do të hyjnë në fuqi ndërsa dispozitat e mësipërme do të vazhdojnë të mbesin në fuqi.

3.3 Në pajtim me nenin 3.1 dhe 3.2, kjo Marrëveshje mbetet në fuqi përveç nëse shkëputet sipas nenit 12 (Shkëputja).

4. Data e Hyrjes në Fuqi

4.1 Data e Hyrjes në Fuqi do të jetë Data e Përmbylljes.

4.2 Në pajtim me Nenin 4.3, KEDS do ta njoftojë KEK-un në intervale të arsyeshme dhe në mënyra tjera nëse kjo kërkohet me arsye nga KEK-u, mbi spektrin kohor gjatë të cilit do të përcaktohet data kur KEDS-i me arsye beson se do të ndodh Data e Përmbylljes.

4.3 KEDS-i do t'i ofrojë KEK-ut jo më pak se:

4.3.1 Njoftim paraprak prej gjashtë muajsh mbi supozimin e vet, të cilin e bën në mirëbesim, mbi datën apo datat në të cilat vlerëson se do të bie Data e Përmbylljes;

4.3.2 Njoftim paraprak prej tre muajsh mbi supozimin e vet, të cilin e bën në mirëbesim, mbi datën apo datat në të cilat vlerëson se do të bie Data e Përmbylljes.

4.3.3 Njoftim paraprak prej një muaji mbi supozimin e vet, të cilin e bën në mirëbesim, mbi datën apo datat në të cilat vlerëson se do të bie Data e Përmbylljes;

4.3.4 Njoftim paraprak prej një jave mbi supozimin e vet, të cilin e bën në mirëbesim, mbi datën apo datat në të cilat vlerëson se do të bie Data e Përmbylljes;

4.3.5 Njoftim paraprak prej tri ditësh mbi supozimin e vet, të cilin e bën në mirëbesim, mbi datën apo datat në të cilat vlerëson se do të bie Data e Përmbylljes; dhe

4.3.6 Njoftim paraprak 24 orë para datës së caktuar;

gjithsesi me kusht që në rast se KEDS-it i bëhet me dije fakti se njoftimet e dhëna sipas Neneve 4.3.1 deri 4.3.5 (përfshirë këtë të fundit) është i pasaktë, atëherë i njëjti do ta informojë KEK-un për supozimin më të mirë, të bërë në mirëbesim, sa i përket datës apo dateve të përmbylljes.

5. Shitja dhe Blerja e Energjisë Elektrike

5.1 KEK-u do të ruaj rendin dhe do të sigurojë disponueshmëria optimale të kapaciteteve gjeneruese në stabilimentet e Kosovës A dhe Kosovës B, në pajtim me Praktikën e Ndërmarrjeve të Kujdesshme dhe, përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, do t'ia shesë KEDS-it tërë energjinë elektrike që mund të furnizohet nga këto stabilimente, të cilën KEDS-i mund ta kërkojë kohë pas kohe sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.2 KEDS-i do të blejë energjinë elektrike nga KEK-u në baza joekskluzive në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe do t'ia paguajë KEK-ut Ngarkesat për Energji dhe

Ngarkesat për Kapacitet për blerjet e bëra. KEDS-i kësaj do të blejë energjinë elektrike për:

- 5.2.1 Të kryer funksionin e Furnizimit Publik;
- 5.2.2 Të gjithë konsumatorët e privilegjuar të përcaktuar në Pjesën 1 të Shtojcës 2, të cilët në ditën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje ishin konsumatorë të shërbimeve që do t'i përkasin afarizmit të KEDS-it;
- 5.2.3 Të gjithë konsumatorëve të privilegjuar të cilët në çfarëdo kohe do të jenë në gjendje të blejnë energjinë elektrike nga KEDS-i në bazë të çmimeve të rregulluara tarifore për energjinë elektrike të cilat caktohen nga ZRRE; dhe
- 5.2.4 Operim efikas të sistemit të KEDS-it (përfshirë energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në shpërndarje) dhe mirëmbajtje dhe shërbime tjera të cilat mund të jenë të domosdoshme për operimin e sistemit të KEDS-it;

gjithsesi me kusht që asgjë në këtë Marrëveshje, qoftë e shprehur apo e nënkuptuar, të mos kufizojë apo ndalojë blerjen nga KEDS-i të energjisë elektrike nga cilado palë tjetër, për qëllimet e mësipërme dhe/ose për pjesëmarrje të KEDS-it në tregjet tjera të energjisë elektrike, nga burime tjera të energjisë elektrike dhe në bazë të marrëveshjeve të tjera të cilat mund të lidhen edhe me palë të treta.

- 5.3 Shitja dhe blerja e energjisë elektrike do të zhvillohen në Pikat e Interkoneksionit (të cilat identifikohen në datën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje në Pjesën 2 të Shtojcës 2) dhe/ose të për të cilat mund të arrihet pajtimi në faza të mëvonshme.
- 5.4 Që nga Data e Hyrjes në Fuqi, KEK-u do t'ia deklarojë KEDS-it disponueshmëria e Kosovës A dhe Kosovës B.
- 5.5 KEDS-i e kupton dhe pranon se KEK-u do të ofrojë disa shërbime të caktuara ndihmëse për KOSTT-in, në bazë të Kodit të Rrjetit; dhe obligimet e KEK-ut për ta deklaruar dhe t'ia shitur energjinë elektrike KEDS-it do të bëhen duke marrë parasysh ofrimin e shërbimeve në fjalë.
- 5.6 Ajo pjesë e energjisë elektrike e cila mund të prodhohet në Kosovën A dhe Kosovën B, e cila nuk është nominuar nga KEDS-i për furnizim, mund të shitet nga KEK-u blerësve tjerë të energjisë elektrike, por vetëm pasi të jetë deklaruar si në dispozicion të KEDS-it dhe KEDS-i të mos e ketë nominuar këtë energji elektrike për furnizim.
- 5.7 KEDS-i nuk do të obligohet të blejë nga KEK-u ndonjë sasi minimale të energjisë elektrike në asnjë periudhë kohore; çdo herë me kusht që së pari të nominojë furnizimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme për gjenerimin e energjisë (ose në rastet kur KEDS-i ka obligim tjetër ligjor për të nominuar burimet tjera të gjenerimit si prioritet), KEDS-i do të nominojë kërkesat për furnizim me energji elektrike dhe rrjedhat e energjisë elektrike për Funksionin e vet si Furnizues Publik nga Kosova A dhe Kosova B, në masën e deklaruar si në dispozicion në Nenin 5.4.
- 5.8 Nga Data e Hyrjes në Fuqi, KEDS-i do të nominojë kërkesat e veta për furnizim me energji elektrike dhe rrjedhat e energjisë elektrike të cilat duhet t'i furnizohen KEDS-it.

- 5.9 Energjia elektrike e cila nominohet kësajsoj nga KEDS-i do t'i liferohet KOSTT-it nga KEK-u, në pajtim me Kodin e Rrjetit dhe/ose Rregullat e Tregut në fuqi.
- 5.10 KEDS-i do të bëjë të gjitha nominimet përkatëse të domosdoshme, të cilat i nevojiten KOSTT-it për të siguruar dispeçimin përkatës të KEK-ut dhe blerjen e energjisë elektrike nga KEDS-i dhe të gjithë konsumatorët relevantë të privilegjuar, në pajtim me Kodin e Rrjetit.
- 5.11 Së paku gjashtë muaj para Datës së mundshme të Hyrjes në Fuqi, Palët do të këmbëjnë nominimet joobligative, të përcaktuara në mirëbesim, sipas Neneve 5.4 dhe 5.8, në mënyrë që nominimet obligative të hyjnë në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi.
- 5.12 KEK-u do ta dëmshpërblejë, do ta mbrojë dhe nuk do ta konsiderojë KEDS-in përgjegjës për çfarëdo pagese për balancim apo pagesa tjera të çfarëdo lloji apo natyre të cilat i paguhen KOSTT-it nga KEK-u, qoftë në lidhje me kyçjet apo shfrytëzimin e sistemit të transmisionit apo që rrjedhin nga dështimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i KEK-ut për t'i siguruar KOSTT-it energjinë elektrike të nominuar për furnizim nga KEDS-i sipas kësaj Marrëveshjeje.
- 5.13 KEDS-i do ta dëmshpërblejë, do ta mbrojë dhe nuk do ta konsiderojë KEK-un përgjegjës për çfarëdo pagese për balancim apo pagesa tjera të çfarëdo lloji apo natyre të cilat i paguhen KOSTT-it nga KEK-u, qoftë në lidhje me kyçjet apo shfrytëzimin e sistemit të transmisionit apo që rrjedhin nga dështimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i KEDS-it për ta blerë nga KOSTT-i energjinë elektrike të nominuar për furnizim nga KEDS-i sipas kësaj Marrëveshjeje.
- 5.14 Tarifa e cila do t'i paguhet KEK-ut nga KEDS-i për energjinë elektrike të furnizuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të përcaktohet në Nenin 6.

6. Tarifa

- 6.1 Tarifa do të përbëhet nga Pagesa për Energji dhe Pagesa për Kapacitet për Kosovën A dhe Kosovën B, e cila i paguhet KEK-ut nga KEDS-i në baza mujore.
- 6.2 Pagesa për Energji dhe Pagesa për Kapacitet do jenë pagesat e përshkruara për energjinë e liferuar nga Kosova A dhe Kosova B dhe për disponueshmëria e tyre, të shprehura në Euro për MWh, në bazë të rregullimeve të kohëpaskohshme të ZRRE-së dhe në pajtim me rregullat e përcaktimit të çmimeve, si shpenzime të cilat KEDS-i mund t'i rikuperojë në bazë të tarifave të veta të rregulluara për furnizim të energjisë elektrike.
- 6.3 Tarifat do të paguhen në masën dhe mënyrën e përcaktuar në Nenin 7.

7. Pagesat

- 7.1 Më së largu deri në ditën e pestë (përfshirë) të secilin Muaj, KEK-u do t'ia dërgojë KEDS-it faturën për tarifën e pagueshme nga KEDS-i për muajin paraprak. Fatura do të paraqesë se si janë kalkuluar Pagesa për Energji dhe Pagesa për Kapacitet, dhe të gjitha tatimet e pagueshme mbi këto pagesa, si dhe shumën e gjithmbarshme që duhet paguar.
- 7.2 Në pajtim me Nenin 7.3, KEDS-i do t'i paguajë të gjitha shumat që i ka borxh sipas faturave në fjalë, jo më vonë se deri në ditën e dhjetë të atij Muaji, apo pesë ditë pas

pranimit të faturës së KEK-ut, në rast se fatura në fjalë është pranuar pas ditës së pestë të Muajit.

- 7.3 Në rast se KEDS-i ka ndonjë kontest *bona fide* në lidhje me ndonjë shumë të faturuar, atëherë ai do të paguajë shumën e pakontestuar, në pajtim me Nenin 7.2. Të gjitha shumat e pakontestuara që paguhen pas datës së përcaktuar në Nenin 7.2 do të paguhen me kamatë prej tetë për qind (8%) mbi normën e LIBOR-it nga data në të cilën është dashur të kryhet pagesa për faturën e kontestuar deri në datën e kryerjes së pagesës. Në rast të shumave të kontestuara, kamata do t'i bashkëngjitet shumës që pajtuar apo përcaktuar për pagesë nga data në të cilën pagesa për faturën e kontestuar është dashur të bëhet deri në datën e kryerjes së pagesës, me normë prej tetë për qind (8%) mbi LIBOR.

8. Kodi i Rrjetit, Kodi i Njehsimit dhe Kycja në Sistem.

- 8.1 Palët do të lidhin kode dhe marrëveshjeve relevante me KOSTT-in, në pajtim me kodet dhe rregullat e tregut në fuqi.

9. E pashfrytëzuar.

10. Fuqia madhore

- 10.1 “Fuqia madhore” do të nënkuptojë çdo ngjarje apo rrethanë apo kombinim të ngjarjeve apo rrethanave (përfshirë edhe efektet e tyre), të cilat nuk janë nën kontroll të arsyeshëm të ndonjërisë Palë dhe të cilat ndikojnë materialisht dhe negativisht në kryerjen e obligimeve të asaj Pale, sipas kësaj Marrëveshjeje (përfshirë edhe aftësinë e Palës për të furnizuar apo pranuar energji elektrike); me kusht, megjithatë, që ky efekt material dhe negativ të kishte pasur mundësi të parandalohet, tejkalohet apo rregullohet tërësisht apo pjesërisht nga Pala e prekur, duke ushtruar kujdes të arsyeshëm (dhe në pajtim me Praktikat e Ndërmarrjeve të Kujdesshme në rastin e KEDS-it), duke qenë e nënkuptuar dhe e miratuar se kujdesi i arsyeshëm përfshin veprimet dhe veprimtaritë që janë të arsyeshme kundrejt probabilitetit të shfaqjes së ngjarjes në fjalë, efektin e mundshëm të saj në rast të shfaqjes, dhe efikasitetin e mundshëm të masave mbrojtëse. Në rast të kënaqjes së kushteve të mëparshme për përkufizimin e një rastit të një Fuqie Madhore në të gjitha fazat, ngjarje të tilla mund të jenë, pa u kufizuar, rastet në vijim:

10.1.1 Zjarri, vërshimet, vetëtimat, stuhia, tornado, tërmeti, rrëshqitja e tokës;

10.1.2 Sëmundjet epidemike;

10.1.3 Lufta, lufta civile, aktet e armiqve publikë; dhe/ose

10.1.4 Greva, lokauti dhe pengesat tjera industriale.

- 10.2 Rastet e Fuqisë Madhore nuk do të përfshijnë në mënyrë shprehimore gjendjet në vijim, përveç nëse këto ngjarje apo rrethana shkaktohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo si rrjedhojë e Rasteve të Fuqisë Madhore:

10.2.1 Dështimi nga QK për të ushtruar autorizimet ligjore të saj; apo

- 10.2.2 Mungesa e fondeve dhe në rastin e KEDS-it mungesa e fondeve për shkak të arsyeve komerciale, ekonomike apo financiare, përfshirë pamundësinë e Palës për të pasur profit apo për të arritur një normë të kënaqshme të kthimit.
- 10.3 Me kusht të pajtueshmërisë me Nenin 5.5, asnjëra Palë nuk përjashtohet nga performansa dhe nuk do të konsiderohet se ka dështuar në kryerjen e obligimeve të përcaktuara këtu, për aq sa kryerja e obligimeve në fjalë të ketë ndodhur për shkak të ndonjë Fuqie Madhore.
- 10.4 Nëse për shkak të ndonjë ngjarjeje të shkaktuar nga Fuqia madhore, njëra Palë është tërësisht apo pjesërisht e paaftë për të kryer obligimet sipas kësaj Marrëveshjeje, Pala e prekur:
- 10.4.1 Do ta njoftojë Palën tjetër për Rastin e Fuqisë Madhore sa më shpejt që praktikisht të jetë e mundur, por në asnjë mënyrë jo më vonë se dyzetetë (48) orë pasi që Pala e prekur të jetë në dijeni për shfaqjen e Rastit të Fuqisë Madhore;
- 10.4.2 Do t'i dërgojë Palës tjetër një njoftim të dytë, në të cilin përshkruan Rastin e Fuqisë Madhore në detaje të arsyeshme dhe, në rast se kjo mund të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme në kohën e dërgimit të njoftimit në fjalë, do të ofrojë një vlerësim preliminar të obligimeve të prekura, një supozim preliminar të periudhës kohore gjatë së cilës Pala e prekur nuk do të jetë në gjendje t'i kryejë obligimet në fjalë dhe çështjet tjera relevante, sa më shpejt që praktikisht të jetë e mundur, por kurrsesi jo më vonë se shtatë (7) Ditë pas njoftimit të parë mbi shfaqjen e Rastit të Fuqisë Madhore të dërguar nga Pala e prekur. Kurdo që të jetë e përshtatshme apo kurdo që kërkohet me arsye nga Pala tjetër, Pala e prekur do t'i dërgojë asaj njoftime tjera në të cilat përshkruhet më në tërësi Rasti i Fuqisë Madhore, shkaktarin e saj dhe ofrohen informata mbi përpjekjet të cilat Pala e prekur është duke i ndërmarrë për të shmangur dhe/apo lehtësuar ndikimet e saj, si dhe supozimet, nëse kjo është e praktikueshme, mbi kohën kur Pala e prekur pret me arsye që të jetë në gjendje të kryejë obligimet të cilat janë prekur nga Rasti i Fuqisë Madhore;
- 10.4.3 Pala e prekur më pas do t'i ofrojë njoftime Palës tjetër:
- (a) Në lidhje me ndonjë Rast aktual të Fuqisë Madhore, mbi pushimin e Rastit të Fuqisë Madhore, dhe
 - (b) Për aftësinë e saj për të rifilluar me kryerjen e obligimeve të veta sipas kësaj Marrëveshjeje.
- Sa më shpejt që të jetë e mundur dhe kurrsesi jo më vonë se shtatë (7) Ditë pas shfaqjes së ngjarjes sipas Neneve (a) dhe (b) më sipër; dhe
- 10.4.4 Dështimi nga Pala e prekur për ta njoftuar me shkrim Palën tjetër për Rastin e Fuqisë Madhore brenda dyzetetë (48) orësh, nuk do ta parandalojë Palën e prekur që një njoftim të tillë ta japë më vonë; megjithatë, me kusht që në raste të tilla Pala nuk do të falet për dështimin apo vonesat në sigurimin e pajtueshmërisë me obligimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje, deri në momentin e dhënies së pëlqimit në fjalë. Nëse njoftimi në fjalë jepet brenda

periudhës prej dyzetetë (48) orësh, e cila përcaktohet me Nenin 5.8, Pala e prekur nuk do të jetë përgjegjëse për dështimet apo vonesat, në pajtim me Nenin, nga koha e fillimit të ngjarjes relevante të shkaktuar nga Fuqia Madhore.

- 10.5 Pala e prekur do t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet e arsyeshme për të zbutur efektet e shkaktuara nga Fuqia Madhore, përfshirë, mes tjerash, pagesën e shumave të arsyeshme nga Pala e prekur apo në emër të saj; shumat në fjalë janë të arsyeshme në frymën e efikasitetit të mundshëm të masave të zbutjes.

11. Përgjegjësitë dhe Dëmshpërblimet

- 11.1 As KEK-u as KEDS-i nuk do të jenë përgjegjës për Humbjet Konsekuente të tjetrës palë, me kusht çdo herë që në asnjë rrethanë të përcaktuar në këtë Marrëveshje Humbjet Konsekuente të mos përfshijnë obligimin shprehimorë për të bërë pagesa, apo për çfarëdo obligimi tjetër të shprehur për të ofruar dëmshpërblime të përcaktuara me këtë Marrëveshje.
- 11.2 KEK-u do ta dëmshpërblejë, mbrojtë dhe nuk do ta konsiderojë KEDS-in, punonjësit, drejtorët, zyrtarët dhe agjentët e tij, përgjegjës për çfarëdo Humbje Konsekuente të KEK-ut sipas kësaj Marrëveshjeje apo në lidhje me të.
- 11.3 KEDS-i do ta dëmshpërblejë, mbrojtë dhe nuk do ta konsiderojë KEK-un, punonjësit, drejtorët, zyrtarët dhe agjentët e tij, përgjegjës për çfarëdo Humbje Konsekuente të KEDS-it sipas kësaj Marrëveshjeje apo në lidhje me të.
- 11.4 Përveç obligimeve shprehimorë për ta dëmshpërblyer KEK-un, përgjegjësia e KEDS-it sipas kësaj Marrëveshjeje kufizohet në obligimin për ta paguar Tarifën sipas Neneve 6 dhe 7.

12. Shkëputja

- 12.1 Në datën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje, KEDS-i është në dijeni për MBE-në e TCKR-së dhe Kosovës B (MBE të rinovuar dhe pa paragjykuar të drejtën e KEDS-it për të negociuar këto dokumente në tërësi. Në lidhje me këto marrëveshje për blerje të energjisë dhe marrëveshjeve të mëvonshme për blerje të energjisë të cilat mund të shfaqen nga projekte alternative elektroenergjetike me të cilat KEDS-i mund të ketë lidhur marrëveshje (në tekstin e mëtejshëm Marrëveshjet për Blerje të Energjisë)”:
- 12.1.2 Menjëherë pas ditës së parë në të cilën KEDS-i ka mundësinë për të pranuar kapacitetet e plota të stabilimenteve gjeneruese që kanë Marrëveshje për Blerje të Energjisë; dhe
- 12.1.2 Se kapaciteti tejkalon kërkesën maksimale për energji elektrike që nevojitet për ta kryer Funksionin e KEDS-it si Furnizues Publik;

KEDS-i do ta njoftojë menjëherë KEK-un dhe KEK-u mund ta shkëpusë këtë Marrëveshje duke njoftuar KEDS-in jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas njoftimit nga KEDS-i. KEDS-i mund ta shkëpusë këtë Marrëveshje duke njoftuar KEK-un kurdo pas kësaj nëse KEK-u nuk e ka bërë këtë apo nuk ka pasur të drejtë ta bëjë këtë.

12.2 KEK-u nuk do të ketë të drejtën e shkëputjes sipas Nenit 12.1 nëse në momentin kur mund ta dorëzojë njoftimin e shkëputjes:

12.2.1 Kosova A mbetet operacionale dhe ka kapacitet për të gjeneruar energji elektrike, dhe/ose

12.2.2 Margjina e Furnizimit të Rezervuar është e pamjaftueshme për nevojat e KEDS-it për të përputhur furnizimin/kërkesën me sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike tek konsumatorët e KEDS-it;

dhe gjatë dhënies së njoftimit sipas Nenit 12.1 KEDS-i do ta këshillojë KEK-un nëse ekzistojnë kushtet në fjalë. Kjo me kusht që asgjë në këtë Nenit 12.2 të mos kërkojë nga KEK-u që të vazhdojë me operimin e Kosovës A pas datës së dekomisionimit të planifikuar të saj dhe që kjo datë të jetë e ditur në momentin e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

12.3 Pasojat e shkëputjes

12.3.1 KEDS-i do t'ia paguajë të gjitha shumat e mbetura KEK-ut.

12.3.2 KEDS-i do të lejojë dhe do tu mundësojë KEK-ut dhe/ose KOSTT-it hyrjen në objektet e KEDS-it për të larguar pajisjet e KEK-ut/KOSTT-it, me kusht që KEK/KOSTT të mos shkaktojnë kurrfarë dëmi ndaj pronës apo lëndim të punëtorëve të KEDS-it dhe/ose KEDS-it, dhe do të dëmshpërblejë, mbrojë dhe nuk do ta konsiderojë përgjegjës për çfarëdo dëmi apo pretendimi të palëve të treta që shfaqen në lidhje me dëmet në fjalë apo me ngjarjen që ka shkaktuar dëmet e tilla.

12.3.3 Shkëputja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë tek të drejtat apo obligimet e cilësdo Palë që mund të jetë shfaqur deri në datën e shkëputjes dhe nuk do të ndikojë në vazhdimin e kryerjes së obligimeve ndaj palës tjetër të cilat janë përcaktuar se mbijetojnë shkëputjen e kësaj Marrëveshjeje.

13. Ndarja

13.1 Nëse për çfarëdo arsye ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje konsiderohet e shfuqizuar, joligjore apo e pazbatueshme, apo nëse shpallet nga gjykata kompetente apo çfarëdo tjetër autoriteti kompetent të jetë e shfuqizuar, joligjore apo e pazbatueshme, apo nëse autoriteti i tillë kompetent:

13.1.1 Refuzon apo formalisht tregon ose shfaq synimin për të refuzuar autorizimin apo përjashtimin e dispozitave apo aranzhimeve të kësaj Marrëveshjeje (në rast të refuzimit, kjo mund të bëhet përmes refuzimit të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës që kjo Marrëveshje të ndryshohet apo që dispozitat e saj të largohen apo që njëra Palë të garantojë apo të pranojë kushte për sjelljen në të ardhmen); apo

13.1.2 Formalisht tregon se vazhdimi i veprimit sipas ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje mund t'i ekspozojë Palët ndaj sanksioneve sipas ndonjë ligji, urdhri, dekreti apo rregulloreje, apo kërkon që Pala të garantojë apo të pranojë

kushte lidhur me sjelljen në të ardhmen, në mënyrë që ajo Palë të mos të pësojë nga sanksionet e tilla në të ardhmen; atëherë

në të gjitha rastet, fillimisht apo në fund të një periudhe të përjashtimit, Palët do të negociojnë në mirëbesim me qëllim të arritjes së pajtimit mbi një apo më shumë dispozita të cilat mund të zëvendësojnë dispozitat e shfuqizuara, të pazbatueshme apo joligjore, dhe të cilat dispozita zëvendësuese janë të kënaqshme për të gjitha Autoritetet Kompetente, dhe të sajojnë sa më shpejt që praktikisht të jetë e mundshme të gjitha rrethanat për të siguruar balancim adekuat të interesave komerciale të Palëve.

14. Variacionet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet apo amandamentohet vetëm me marrëveshje me shkrim mes të dy Palëve.

15. Zotimet dhe Garancitë

15.1 Në mënyrë të pakushtëzuar dhe të përvokueshme dhe deri në masën maksimale të lejuar me ligj, KEK-u:

15.1.1 Pajtohet se ekzekutimi, liferimi dhe ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje nga ana e tij nuk do të përbëjnë akte sovrane;

15.1.2 Pajtohet se në rast të ngritjes së çfarëdo procedure kundër tij në lidhje me këtë Marrëveshje apo me transaksionet e parapara në këtë Marrëveshje, nuk do të kërkohet apo pretendohet nga vetë ai apo nga të tjerët kurrfarë imuniteti sovran nga procedurat e tilla, megjithëse një imunitet i tillë do të lejohej me ligj.

15.1.3 Deri në masën maksimale të lejuar me ligj, heq dorë nga çfarëdo e drejte sovrane, të cilat ai apo ndonjë entitet i ndërlidhur me të e ka apo mund ta fitojë në të ardhmen.

15.2 Zotimet dhe Garancitë e KEK-ut:

15.2.1 KEK-u zotohet dhe i garanton KEDS-it se në Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje:

(a) Është organizatë e themeluar apo e krijuar dhe organizuar sipas ligjeve të Kosovës dhe përfaqëson një person ekzistues juridik sipas ligjeve të Kosovës, dhe është i kontrolluar nga Qeveria e Kosovës;

(b) Ka aftësi të plotë juridike dhe autoritet për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të kryer obligimet e parapara në të. Kjo Marrëveshje përcakton obligimet valide dhe juridikisht obligative dhe të zbatueshme të KEK-ut dhe nuk është në konflikt me asnjë marrëveshje tjetër obligative të tij;

(c) Të gjitha miratimet e domosdoshme për t'i mundësuar KEK-ut lidhjen e kësaj Marrëveshjeje dhe për të realizuar obligimet e përcaktuara në të janë marrë dhe pranuar dhe do të mbesin në fuqi dhe do të kenë efekt;

- (d) Nuk ka dispozita të zbatueshme kushtetuese, ligje, rregullore, dekrete apo rregulla të autoriteteve qeveritare të Kosovës në fuqi në ditën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje apo dispozita të çfarëdo dokumenti organizativ të KEK-ut, që kufizojnë apo i pamundësojnë KEK-ut lidhjen e kësaj Marrëveshjeje dhe jetësimin e kushteve të përcaktuara në të. KEK-u nuk ka të drejtë të thirret në imunitet sovran apo tjetër nga procedurat ligjore apo juridiksioni juridik;
- (e) Kjo Marrëveshje nuk është në kundërshtim me dispozitat e asnjë ligji apo rregulloreje të Kosovës që është në fuqi në datën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje;
- (f) Lidhja, zbatimi dhe kryerja e obligimeve sipas kësaj Marrëveshjeje nuk është në kundërshtim me memorandumet e KEK-ut, aktin themeltar të tij apo dokumentet tjera të ngjashme organizative; dhe
- (g) Kundër KEK-ut nuk ka asnjë padi, procedurë arbitrazhi, administrative apo tjetër që do të ndikonte plotfuqishmërinë e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje apo në aftësinë e KEK-ut për të përmbushur obligimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje.

15.3 Zotimet dhe Garancitë e KEDS-it:

15.3.1 KEDS-i zotohet dhe i garanton KEK-ut se në Datën e Hyrjes në Fuqi:

- (a) Se është subjekt juridik ekzistues sipas ligjeve të Kosovës;
- (b) Se ka aftësi të plotë juridike dhe autoritet për të lidhur dhe kryer obligimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje. Kjo Marrëveshje përbën një obligim valid, ligjërish të obligueshëm dhe të zbatueshëm të KEDS-it dhe nuk është në kundërshtim me asnjë marrëveshje obligative të tij;
- (c) Të gjitha miratimet dhe licencat e domosdoshme për t'i mundësuar KEDS-it lidhjen e kësaj Marrëveshjeje dhe për të realizuar obligimet e përcaktuara në të janë marrë dhe pranuar dhe do të kenë efekt;
- (d) Nuk ka asnjë dispozitë të ndonjë dokumenti organizativ të KEDS-it që do të kufizonte apo pamundësonte KEDS-it lidhjen e kësaj Marrëveshjeje dhe jetësimin e kushteve të përcaktuara në të.
- (e) Kjo Marrëveshje nuk është në kundërshtim me dispozitat e asnjë ligji apo rregulloreje të Kosovës që është në fuqi në datën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje;
- (f) Lidhja, zbatimi dhe kryerja e obligimeve sipas kësaj Marrëveshjeje nuk është në kundërshtim me memorandumet e KEDS-it, aktin themeltar të tij apo dokumentet tjera të ngjashme organizative; dhe
- (g) Kundër KEDS-it nuk ka asnjë padi, procedurë arbitrazhi, administrative apo tjetër që do të ndikonte plotfuqishmërinë e

zbatimit të kësaj Marrëveshjeje apo në aftësinë e KEDS-it për të përmbushur obligimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje.

16. Konfidencialiteti dhe Publiciteti

Palët pajtohen se kjo Marrëveshje do të jetë dokument në dispozicion të publikut.

17. Delegimi, Transferet e Interesit

17.1 Dispozitat vijuese do të zbatohen sa i përket delegimit apo transferit të kësaj Marrëveshjeje:

17.1.1 KEK-u nuk do t'ia delegojë apo transferojë të gjitha apo disa të drejta, beneficione apo obligime të veta sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse është marrë pëlqimi paraprak me shkrim nga KEDS-i, gjë që do të jetë në diskrecion të plotë të KEDS-it; dhe

17.1.2 KEDS-i nuk do të shesë, delegojë apo transferojë në mënyrë tjetër të gjitha apo disa të drejta, beneficione apo obligime të veta sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse është marrë pëlqimi paraprak me shkrim nga KEK-u, ndërsa pëlqimi i tillë nuk bën të mos jepet apo të vonohet pa arsye, përveç në rastin kur KEDS-i mund t'i delegojë apo transferojë të gjitha apo disa të drejta, beneficione apo obligime të veta sipas kësaj Marrëveshjeje ndonjë filiali të KEDS-it apo të krijojë interes të sigurisë mbi të drejtat dhe interesat e vet sipas kësaj Marrëveshjeje për Huadhënësit apo Filialet e KEDS-it.

18. Njoftimet

18.1 Përveç rasteve të përcaktuara në procedurat operative në Shtojcën 5, të gjitha njoftimet që bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhen me shkrim dhe në gjuhën angleze dhe shqipe, ndërsa të gjitha certifikatat, njoftimet apo udhëzimet me shkrim që bëhen në bazë të kësaj Marrëveshjeje duhet të dorëzohen duke i dërguar me postë, faksimil, apo me dorë në adresat:

18.1.1 KEDS:

Ndërtesa e Elektrokosovës

Nr.3 Bulevardi Bill Klinton,

Prishtina, Republika e Kosovës

Për: Drejtorin Menaxhues, dhe

KEK:

Termocentrali Kosova B

Obiliq/Kastriot, Republika e Kosovës

Për: Drejtorin Menaxhues

18.1.2 Njoftimet e bëra me shkrim dhe të dorëzuara me dorë apo të dërguara me postë të parapaguar të klasit të parë, transmisionit me faksimil do të konsiderohet se janë pranuar:

(a) Në momentin e dorëzimit, në rast të dorëzimit me dorë; ose

(b) Në ditën e dytë pas dorëzimit në postë, në rast të dërgimit me postë të parapaguar të klasit të parë; ose

(c) Në kohën aktuale të pranimit, në rast të dërgimit me faksimil;

18.2 Cilado Palë e kësaj Marrëveshjeje mund ta ndryshojë adresën e vet apo numrin e faksimilit, pas njoftimit paraprak të Palës tjetër.

18.3 Në rast të ndonjë konflikti mes versioneve në gjuhën angleze dhe shqipe, teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

19. Tërësia e Marrëveshjes

19.1 Kjo Marrëveshje përbën tërë Marrëveshjen e lidhur mes Palëve në lidhje me shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike mes palëve dhe përjashton çfarëdo zotimi, negociimi apo ndërmarrje paraprake.

20. Heqja dorë

20.1 Asnjë heqje dorë apo dështim nga Palët për të kërkuar zbatim strikt të kësaj Marrëveshjeje apo për të vepruar kundrejt dështimit të Palës tjetër, dhe kurrfarë pranimi i pagesave për performansë gjatë kohës së dështimit të tillë nuk parandalon kërkimin e të drejtave, mjeteve ligjore apo përmirësimit të gjendjes sipas kësaj Marrëveshjeje, të cilat i garantohen Palës që nuk ka dështuar në zbatimin e saj; të njëjtat nuk mund të konsiderohen nga Pala dështuese si pajtim për dështimet në fjalë apo për përsëritjen e tyre.

21. Trashëgimtarët

21.1 Kjo Marrëveshje obligon dhe mbijeton për t'i sjellë përfitime Palëve dhe trashëgimtarëve përkatës të tyre.

22. Marrëdhënia mes Palëve

22.1 Kjo Marrëveshje nuk krijon kurrfarë shoqërimi, ndërmarrje të përbashkët apo partneriteti mes Palëve.

22.2 Asnjëra palë nuk ka të drejtë, mandat apo autoritet për të hyrë në çfarëdo marrëveshje apo ndërmarrje për palën tjetër, apo në emër të saj, apo për të vepruar si agjent ose përfaqësues i saj, ose për t'i krijuar obligim asaj.

23. Mirëbesimi

23.1 Palët zotohen se do të veprojnë në mirëbesim në lidhje me jetësimin dhe implementimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për të ndërmarrë masa të arsyeshme që mund të jenë të domosdoshme për realizimin e objektivave të tyre.

24. Siguri të mëtejme

- 24.1 Palët pajtohen se do të ekzekutojnë dhe sigurojnë instrumentet tjera dhe se do të bëjnë dhe nxjerrin të gjitha aktet dhe gjërat tjera që janë të domosdoshme për realizimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

25. Imuniteti sovran

Nëse KEK-u ka mundësi që në çfarëdo juridiksioni të pretendojë për vete apo për asetet apo të hyrat e veta imunitet nga padia, ekzekutimi, veprimet tjera (qoftë në ndihmë të ekzekutimit, gjykimit apo përndryshe) apo proceset tjera ligjore në çfarëdo juridiksioni dhe nëse në çfarëdo juridiksioni të tillë imunitet i tillë mund t'i atribuohet aseteve apo të hyrave të tilla (qoftë i pretenduar apo jo), atëherë KEK-u pajtohet që të mos pretendojë atë dhe në mënyrë të përvokueshme heq dorë nga ai imunitet në masën e plotë të lejuar nga ligjet e juridiksionit në fjalë. Më tej, KEK-u në mënyrë të pakushtëzuar dhe të përvokueshme dhe deri në masën maksimale të lejuar me ligj:

- 25.1.1 Pajtohet se ekzekutimi, realizimi dhe jetësimi i kësaj Marrëveshjeje nga ai nuk përbëjnë akte sovraane;
- 25.1.2 Pajtohet se, në rast të shfaqjes së çfarëdo procedurash kundër saj në lidhje me këtë Marrëveshje apo me transaksionet e parapara me të, kurrfarë imuniteti sovran nga këto procedura, të cilin ka të drejtë përndryshe ta pretendojë, nuk do të kërkohet nga ajo apo në emër të saj; dhe
- 25.1.3 Deri në masën maksimale të lejuar me ligj, heq dorë nga të gjitha të drejtat e imunitetit sovran, të cilin ajo apo ndonjë subjekt i ndërlidhur i saj do të mund ta kërkojë në të ardhmen.

26. Kostot

Të gjitha palët do të bartin kostot dhe shpenzimet e veta të cilat i kanë pasur në kuptim të lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

27. Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të lidhet në numër të pakufizuar të kopjeve, ndërsa të gjitha ato së bashku do të konsiderohet se përbëjnë një dokument të vetëm.

28. Zgjidhja e kontesteve dhe ligji i zbatueshëm

- 28.1 Nëse mes Palëve shfaqet ndonjë kontest lidhur me këtë Marrëveshje (në tekstin e mëtejshëm 'Kontesti'), cilado palë në kontest mund ta njoftojë palën tjetër në kontest dhe të kërkojë nga ajo që kontesti t'i referohet Kryeshefit Ekzekutiv në KEK dhe një përfaqësuesi të caktuar të Investitorit (në emër të KEDS-it), të cilët do të përpiqen që ta zgjidhin kontestin përmes diskutimit.
- 28.2 Nëse Kontesti nuk zgjidhet brenda njëzet (20) Ditëve të Punës pas njoftimit të dhënë në bazë të Nenit 28.1 përmes diskutimit, e nëse kontesti në fjalë duhet sipas kësaj Marrëveshjeje t'i dërgohet për shqyrtim një Eksperti apo nëse Palët pajtohen me shkrim që çështjen t'ia referojnë një Eksperti pasi që ajo ka të bëjë me çështje teknike, cilado Palë mund të kërkojë që Kontesti t'i referohet një Eksperti, në pajtim me procedurën e

specifikuar në Nenin 28.3, dhe duke njoftuar palën tjetër me shkrim (përfshirë edhe SPV-në).

28.3 Palët në Kontest do të emërojnë së bashku një Ekspert brenda njëzet (20) Ditëve të Punës, apo brenda afatit më të gjatë që mund të përcaktohet nga Palët në Kontest, pas datës së pranimit të njoftimit nga pala të cilës i adresohet njoftimi i dërguar sipas Nenit 28.2. Nëse Palët në Kontest nuk arrijnë të pajtohen për një person të caktuar, ato mund të aplikojnë pranë Qendrës për Ekspertizë të Odës Tregtare Ndërkombëtare dhe të kërkojnë nga ajo që ta bëjë emërimin e një personi brenda njëzet (20) Ditëve të Punës pas datës së pranimit të kërkesës në fjalë. Në rast të zgjidhjes së një Kontesti nga një Ekspert do të zhvillohet procedura në vijim, ndërsa Palët do të sigurohen se ajo do të pasqyrohet edhe në termat e referencës së Ekspertit:

28.3.1 Eksperti:

- (a) Do t'i japë të gjitha Palëve në Kontest mundësinë për të bërë paraqitje gojore dhe/ose me shkrim lidhur me Kontestin, brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve të Punës nga data e emërimit të tij;
- (b) Do të nxjerr vendimin e tij brenda tridhjetë (30) Ditëve të Punës (apo brenda një periudhe më të gjatë nëse kjo është vendosur nga Eksperti, por jo më vonë se pas dyzetepesë (45) Ditëve të Punës) nga emërimi i tij;
- (c) Do ta përcaktojë vlerën e kompensimit të tij dhe përgjegjësitë e Palëve në Kontest lidhur me kompensimin dhe shpenzimet e tij; dhe
- (d) Do tu japë të gjitha Palëve në Kontest kopje të vendimit të tij dhe arsyet për vendimin e marrë.

28.3.2 Palët në Kontest do t'ia sigurojnë Ekspertit dhe njëra – tjetrës të gjitha dëshmitë dhe informatat që i kanë në posedim apo që janë nën kontrollin e tyre e të cilat Eksperti i konsideron të domosdoshme për të vendosur për Kontestin apo të cilat janë relevante për Kontestin apo kanë ndikim mbi të.

28.3.3 Nëse Eksperti nuk arrin të merr vendimin e tij sipas Nenit 28.3.1 brenda periudhës kohore të përcaktuar në Paragrafin (b) të Nenit 28.3.1, cilado Palë në Kontest mund të kërkojë, përmes dorëzimit të një njoftimi me shkrim tek Pala tjetër, që Kontesti të vendoset duke iu referuar arbitrazhit, me ç'rast Eksperti do të udhëzohet të mos e shqyrtojë më lëndën në fjalë.

28.3.4 Eksperti nuk do të veprojë si arbitër, por do të vendos mbi Kontestin duke shfrytëzuar shkathtësitë, përvojën dhe njohuritë e tij dhe lidhur me çështjet të cilat në mënyrë shprehimore përcaktohen në këtë Marrëveshje si çështje që ai në cilësinë e Ekspertit vlerëson se duhet shqyrtuar. Vendimi i Ekspertit i cili nxirret në pajtim me këtë Nen 28.3 (dhe duke iu përmbajtur Nenit 28.3.3) do të jetë përfundimtar dhe obligative për të gjitha palët, përveç në rast të falsifikimeve apo gabimeve evidente.

28.3.5 Përveç nëse vendimi i Ekspertit është lënë anash për arsyet e specifikuar në Nenin 28.3.4, Palët në Kontest me këtë rast pajtohen se do t'i përmbahen atij,

se do ta zbatojnë këtë Marrëveshje në pajtim me vendimin e marrë nga Eksperti, si dhe pajtohen ta zbatojnë vendimin e tij nëse kjo është e domosdoshme. Dështimi i ndonjëris Palë në Kontest për të vepruar kështu do të përbëjë shkelje të Marrëveshjes. Kontestet lidhur me vendimet e Ekspertit duhet t'i nënshtrohen arbitrazhit që zhvillohet në pajtim me Nenin 28.4. Gjykata e Arbitrazhit do të obligohet nga vendimi i Ekspertit dhe e vetmja gjë që Gjykata e Arbitrazhit do të përcaktojë është nëse Palët në Kontest u janë përmbajtur vendimit të Ekspertit.

28.3.6 Në rast se Eksperti nuk ka vullnet apo nuk është në gjendje që të veprojë në lidhje me ndonjë Kontest apo (nëse është firmë apo partneritet) mbyllet apo (nëse është kompani) shkon në likuidim, për qëllime tjera nga rekonstrukcioni apo bashkimi me një subjekt tjetër, apo nëse fillon të zhvillojë afarizmin nën një administrator, pranues, menaxher apo likuidues në të mirë të kreditorëve të tij, atëherë Palët në Kontest do të pajtohen mbi emërimin e një eksperti tjetër zëvendësues. Zëvendësuesi do të zgjidhet në pajtim me procedurën e përcaktuar në këtë Nen (28.3).

28.4 Duke iu përmbajtur Nenit 28.2, çdo kontest, dallim, kundërthënie apo pretendim që rrjedh apo ndërlidhet me këtë Marrëveshje, apo me shkeljen, shkeljetjen apo pavlefshmërinë e saj, do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht me arbitrazh, në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL), të cilat janë të zbatueshme për momentin, apo, në rast se rregulla të caktuara të zbatueshme të arbitrazhit të UNICTRAL-it për çështjen në fjalë janë përjashtuar përmes kësaj Marrëveshjeje, në bazë të së drejtës procedurale të Zvicrës, me kusht që:

28.4.1 deklarata mbi pretendimin dhe njoftimi mbi emërimin e arbitrit të përfshihen në njoftimin e arbitrazhit;

28.4.2 autoriteti emëruar do të jetë Presidenti i Odës Tregtare të Gjenevës; numri i arbitrave do të jetë 3 (tre);

28.4.3 vendi i arbitrazhit do të jetë Gjeneva, Zvicër;

28.4.4 gjuha e zhvillimit të procedurës së arbitrazhit do të jetë gjuha angleze;

28.4.5 neni 22 i Rregullave të UNICTRAL-it nuk do të zbatohet dhe palët nuk do të lejohen që të ndryshojnë apo plotësojnë deklaratën e tyre të pretendimeve apo deklaratën mbrojtëse përveç nëse pala tjetër pajtohet me shkrim, apo nëse gjykata e arbitrazhit e konsideron si adekuate që të lejojë ndryshimin apo plotësimin në fjalë, duke marrë parasysh vonesat në sajimin e saj dhe çdo lloj paragjykimi që mund t'i shkaktohet palës tjetër apo rrethanat tjera relevante;

28.4.6 secila palë mund të kërkojë dëgjim gojor, por gjykata e arbitrazhit e themeluar në pajtim me këtë nen 28 (në tekstin e mëtejshëm 'Gjykata e Arbitrazhit') do të mund të nxjerr vendim diskrecional nëse dëgjimi i tillë do të mbahet, përveç nëse kjo kërkesë përkrahet edhe nga pala tjetër;

28.4.7 Gjykata e Arbitrazhit nuk do të jetë e autorizuar që të vendosë në kapacitetin e "*amiables compositeurs*" apo "*ex aequo et bono*" apo të zbatojë nenin 27,

paragrafi 3, apo nenin 29, paragrafi 3 të Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL, në rast se dispozitat në fjalë kanë të bëjnë me inspektimin apo sajimin e dokumenteve. Gjykata e Arbitrazhit mund të kërkojë nga palët parashtrimin e dokumenteve, dëshmime dhe provave të tjera të cilat Gjykata e Arbitrazhit i konsideron relevante, brenda orarit kohor të cilin ajo e cakton. Nëse një palë që bartë barrën e së provuarit të fakteve të cilat e përkrahin pretendimin apo mbrojtjen e saj nuk dëshiron të zbulojë dokumentet, dëshmitë apo provat në fjalë, atëherë Gjykata e Arbitrazhit do të jetë e lirë që të shqyrtojë nëse të gjitha faktet dhe rrethanat janë dëshmuar apo jo;

- 28.4.8 Neni 37 dhe neni 39 i Rregullave të Arbitrazhit të UNICTRAL nuk do të zbatohen;
- 28.4.9 Gjykata e Arbitrazhit nuk do të ketë të drejtë që të nxjerrë vendime të pjesshme apo vendime të përkohshme me masat që rregullohen në nenin 26 të Rregullave të UNCITRAL; dhe
- 28.4.10 vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit të jetë përfundimtar dhe obligues për palët, me kusht që:
- (a) paragrafët (a), (b) dhe (d) të nenit 190 (2) të Ligjit Federal Zviceran për të Drejtën Ndërkombëtare Private të jenë të zbatueshëm;
 - (b) paragrafi (c) i nenit të lartpërmendur 190 (2) të jetë i zbatueshëm vetëm për veprimet për ndarjen e pjesës nga vendimi i marrë që konsiderohet se tejkalon pretendimet e parashtruara para Gjykatës së Arbitrazhit; në asnjë aspekt tjetër nuk mund të iniciohen veprime për të ndarë vendimin e nxjerrë në pajtim me paragrafin e lartpërmendur (c).

Zbatimi i vendimit në fjalë mund të duhet të kryhet nga gjykata apo autoriteti kompetent. Përveç në raste të tilla, përjashtohen të gjitha të drejtat e ankimit, anulimit apo kërkimit pranë gjykatave të rregullta të çfarëdo të drejte të ndërlidhur me këtë marrëveshje, me arbitrazhin që zhvillohet në pajtim me të apo me vendimin që nxirret më pas.

Palët kuptojnë dhe pranojnë se kjo Marrëveshje përbën një transaksion komercial, në lidhje me të cilin asnjëra palë nuk ka të drejtë të thirret në imunitet sovran, ndërsa Shitësi dhe Blerësi me këtë rast heqin dorë në mënyrë të përvokueshme nga imuniteti sovran në rast të çfarëdo veprimi që nxit arbitrazhin sipas kësaj Marrëveshjeje, apo në ekzekutimin apo zbatimin e vendimeve të marra në procedura të arbitrazhit, të zhvilluara në bazë të kësaj saj.

- 28.5 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet dhe kuptohet në të gjitha aspektet në pajtim me ligjet e Kosovës.

DUKE VËRTETUAR SI MË SIPËR, Palët kanë lidhur këtë Marrëveshje në datën e përcaktuar më lartë.

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.

Nënshkruar nga **Arben Gjukaj**
në emër të
KORPORATA ENERGJETIKE E
KSOVOËS SH.A.

.....

Drejtor Menaxhues

Nënshkruar nga **Fadil Çitaku**
Për dhe në emër të
KORPORATA ENERGJETIKE E
KSOVOËS SH.A.

.....

Kryesues, Bordi i drejtorëve, KEK

KEDS

Nënshkruar nga **Mujë Rugova**
Për dhe në emër të:
KEDS

.....

Drejtor i Bordit të Drejtorëve, KEDS

SHTOJCA 1

Pjesa 1

PËRKUFIZIMET

Marrëveshje – do të thotë kjo Marrëveshje për Furnizim me Shumicë;

Filial – do të thotë në lidhje me cilëndo Palë, çdo kompani që është Vartëse e asaj Pale, ose kompani e të cilës ajo Palë është Vartëse, ose kompani që është një Vartëse tjetër e një kompanie, Vartëse e të cilës është ajo Palë;

Tatimet e zbatueshme – nënkupton të gjitha Tatimet e obligueshme me ligj;

Gjykata e Arbitrazhit – ka domethënien e përcaktuar në nenin 28.4.6;

Ditë pune – do të thotë do ditë përveç të shtunave, të dielave dhe festave publike, gjatë së cilës bankat janë të hapura për punë në Kosovë;

Pagesat për kapacitet – ka domethënien e përcaktuar në nenin 6;

Autoriteti kompetent - QK apo ndonjë agjenci e QK-së, ose autoritet rajonal apo shtetëror, departament, inspektorat, ministër, zyrtar, gjykatë, tribunal apo organ publik apo statusor (autonom dhe jo) i Republikës së Kosovës (duke përfshirë edhe për shmangien e dyshimit, çdo autoritet licencues), që ushtron një autoritet statusor, por në gjitha rastet duke përjashtuar ZRRR-në;

Informata konfidenciale – ka domethënien e përcaktuar në termin në nenin 16.3;

Data e përmbylljes – ka kuptimin e dhënë për këtë term në Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve;

Humbjet konsekuente - nënkuptojnë të gjitha humbjet, kostot dhe dëmet financiare sa i përket humbjeve kontraktuale, humbjes së makinerisë apo pronës, humbjes së prodhimitarisë, profitit apo të ardhurave apo humbjeve të tjera ekonomike, kostove apo pretendimeve të çfarëdo natyre apo lloji të palës në lidhje me këtë Marrëveshje dhe/apo kërkesat e palëve të treta për dëme në humbje dhe shpenzime kundrejt njërit Palë gjatë rrjedhës së përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë dështimin apo neglizhencën e ndonjë pale apo shkeljen e detyrave ligjore nga ndonjë palë tjetër), qoftë kjo e parashikueshme apo jo në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;

Ditë – do të thotë periudha kohore prej njëzetekatër orëve duke filluar në ora 0000 dhe përfunduar në ora 2400 të po asaj dite;

Kontest – ka domethënien e caktuar në këtë term në nenin 28.1;

Data e Hyrjes në Fuqi – ka domethënien e dhënë në nenin 4;

Pagesat për energji – ka domethënien e dhënë për këtë shprehje në nenin 6;

ZRRE – do të thotë Zyra e Rregullatorit të Energjisë, autoriteti rregullativ i sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës dhe pasardhësi i saj në çdo funksion përkatës me këtë Marrëveshje;

Ekspert – do të thotë një kompani e pavarur konsulente, kompani apo shoqatë personash me shkathtësi të specializuara në interpretimin e kontratave të inxhinierisë dhe furnizimit të energjisë dhe analizave financiare dhe ekonomike, e emëruar në pajtim me nenin 28.3;

Forca madhore – ka domethënien e dhënë për këtë shprehje në [nenin 10.1];

Rasti i forcës madhore - ka domethënien e dhënë për këtë shprehje në [nenin 10.1];

Qeveria – do të thotë Qeveria e Republikës së Kosovës dhe cilado ministri, departament, agjenci e të njëjtës dhe çdo autoritet statutor i themeluar nga ajo (me përjashtim të ZRRE-së), që ushtron kompetenca ligjore;

Kodi i rrjetit – do të thotë kodi i aplikimit të përgjithshëm kohë pas kohe, i përpiluar nga KOSTT në pajtim me të gjitha detyrimet rregullative të ZRRE-së, i cili përvijon rregullat operacionale që qeverisin KOSTT-in dhe prodhuesit dhe interkonektorë e lidhur dhe përdoruesit e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike të KOSTT-it;

Orë – do të thotë periudha e pandërprerë prej gjashtëdhjetë minutave, duke filluar me minutën e parë të secilës nga njëzetekatër orët e emëruara si Orët të një Dite;

Pikat e interkoneksionit – ka domethënien e dhënë në nenin 5.3;

Investitorët - ka domethënien e dhënë për këtë shprehje në Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve;

Kosova A – do të thotë stabilimenti i prodhuesit të energjisë me këtë emër;

Kosova B – do të thotë stabilimenti i prodhuesit të energjisë me këtë emër;

MBE e Kosovës B (të riparuar) – do të thotë marrëveshja e blerjes së energjisë me këtë emër, e hapur për Palët para datës së kësaj Marrëveshje;

KOSTT – do të thotë KOSTT sh.a., kompani aksionare e organizuar me ligjet e Kosovës, me zyra qendrore në Prishtinë, Kosovë, apo pasardhësi i saj, në rast se KOSTT ndërpret cilindo funksion të Operatorit të Sistemit dhe Tregut të Transmisionit të Energjisë Elektrike sipas Kodit të Rrjetit;

MBE i TCKR-së – do të thotë marrëveshja e blerjes së energjisë me këtë emër e hapur për palët para datës së kësaj Marrëveshjeje;

“LIBOR” nënkupton në lidhje me vlerën dhe valutën e shumës në bazë të së cilës grumbullohet interesi, normën vjetore të 1-muaji-LIBOR, e cila përcaktohet nga Shoqata e Bankierëve Britanikë rreth orës 11:00 të mëngjesit sipas kohës së Londrës, dhe e cila shfaqet në faqet ‘LIBOR01’ të Reuters-it, apo në web-faqen www.bbalibor.com, në ditën e parë të punës së muajit në të cilin duhet bërë pagesa. Norma referente më pastaj duhet të përshtatet në fillim të

secilit muaj vijues ma normën e publikuar për muajin në fjalë sipas përkufizimit të mësipërm, deri në kryerjen e pagesës së plotë;

Huadhënësit – do të thotë bankat dhe/apo institucionet financiare dhe/apo personat tjerë që japin kredi, hua dhe garanci apo aranzhime të financimit (ndryshe nga ato përmes pjesëmarrjes së kapitalit apo kuazi kapitalit), në dispozicion për Investitorët për qëllime të Transaksionit, apo në lidhje me të, apo çdo agjent që vepron në emrin e tyre;

Rregullat e Tregut – do të thotë rregullat e tregut të përpiluara nga KOSTT në pajtim me të gjitha detyrimet rregullative të ZRRE-së, i cili përvijon rregullat e tregut që qeverisin KOSTT-in dhe prodhuesit dhe interkonektorë e lidhur dhe përdoruesit e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike të KOSTT-it;

Megavat – do të thotë një megavat apo 1000 kilovatë;

Muaj – do të thotë periudha kohore që fillon në ora 0000 e ditës së parë dhe përfundon në ora 2400 të ditës së fundit të atij muaji kalendarik, me kusht që:

- a) muaji i parë i periudhës operationale fillon në ora 0000 në datën e operacioneve komerciale të bllokut 1 dhe përfundon në ora 2400 të ditës së fundit të muajit kalendarik në të cilin bie data e operimit komercial të bllokut 1; dhe
- b) muaji i fundit i periudhës operationale përfundon në ora 2400 në ditën e fundit të periudhës operationale;

Marrëveshja(et) për Blerje të Energjisë – ka domethënien e dhënë për këtë shprehje në nenin 12.1;

Praktikat e Ndërmarrjeve të Kujdesshme – do të thotë personi që vepron në mirëbesim me qëllim të përmbushjes së obligimeve kontraktuese sipas kësaj marrëveshje dhe i cili gjatë kryerjes së përgjithshme të detyrave ushtron nivel të shkathtësisë, maturisë dhe kujdesit që do të ushtrohej në mënyrë të arsyeshme dhe të rregullt nga një operator i shkathët dhe me përvojë, në pajtim me ligjet në fuqi dhe duke i aplikuar standardet ndërkombëtare të aplikuara në ndërmarrje të ngjashme të energjisë elektrike;

Funksioni i Furnizuesit Publik – do të thotë funksioni i ndërmarrjes së energjisë elektrike të licencuar për të kryer aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë në tarifa të rregulluara në pajtim me nenin 18 të Ligjit nr. 03/L -201 për energjinë elektrike;

Margjina e Rezervuar e Furnizimit – do të thotë kapaciteti i prodhimit i rezervuar i pakërkuar brenda Republikës së Kosovës, siç mund të përcaktohet kohë pas kohe;

Marrëveshja për Shitblerjen e Aksioneve – do të thotë marrëveshjen e lidhur ndërmjet QK-së, KEK-ut, Investitorëve dhe KEDS-it, në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje, e ndryshuar sipas nevojës, për blerjen e aksioneve të QK-së në KEDS (Distribucion dhe Furnizim) nga ana e Investitorit, në masën e cekur në atë marrëveshje;

Njësi vartëse – do të thotë kompania:

- a) shumica e kapitalit aksionar të cilës është në pronësi të një kompanie tjetër; apo

- b) në të cilën një kompani tjetër ka shumicë kontrolluese në përbërjen e bordit të drejtorëve apo hedhjen e votave në takimin e aksionarëve të asaj kompanie; apo
- c) e cila, apo bordi i drejtorëve i së cilës, zakonisht vepron në përputhje me udhëzimet e një kompanie tjetër;

Tarifa – do të thotë pagesat e pagueshme nga KEDS-i për KEK-un, sipas nenit 6;

Taksat – do të thotë:

- a) të gjitha format e tatimeve direkte dhe indirekte dhe pagesave statusore, qeveritare, shtetërore, federale, krahinore, pushtetit lokal apo komunal, detyrimet (përfshirë detyrimet doganore), taksat, kontributet, apo mbajtjet apo detyrimet e pagueshme qoftë në juridiksion të Kosovës apo një tjetër, të ngarkuar për të ardhura, fitime, pasuri neto, vlerë të aseteve, qarkullim, vlerë të shtuar, apo të tjera (përfshirë kontributet pensionale dhe tatimet tjera në të paga dhe përfshirë taksat e autoriteteve lokale) të aplikuara në çfarëdo mënyre (qoftë përmes mbajtjes në burim apo zbritjes në llogari tatimore, apo mënyra tjera); dhe
- b) çdo gjobë, ndëshkim, ngarkesë, interes, pagesë apo kosto të pagueshme në lidhje me çfarëdo tatimimi në kuadër të pikës (a) më sipër apo kthimit të mëvonshëm apo të pasaktë përkitazi me cilëndo taksë në kuadër të pikës (a);

Transaksion – do të thotë blerja e propozuar nga QK e aksioneve në KEDS (“Distribucion dhe Furnizim”).

Pjesa 2

Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, përveç nëse kërkohet ndryshe nga konteksti:

- (a) referenca në ditë pune është referencë në çdo ditë përveç të dielave, apo festave publike zyrtare në Kosovë;
- (b) referenca në ditë, muaj, apo vit është referencë në ditë, muaj apo vite të kalendarit gregorian;
- (c) referencat në nene, shtojca, pjesë, paragrafë dhe figura janë referenca në nene, shtojca, pjesë, paragrafë dhe figura të kësaj Marrëveshjeje;
- (d) fjalët në njëjës interpretohen duke përfshirë edhe shumësin dhe anasjelltas, dhe fjalët që tregojnë persona fizikë interpretohen ashtu që i referohen korporatave dhe subjekteve tjera juridike dhe anasjelltas, dhe të gjitha referencat në persona përfshijnë pasardhësit dhe të emëruarit e tyre të lejuar;
- (e) termi "përfshirë" interpretohet pa kufizim; përveç nëse konteksti kërkon ndryshe;
- (f) në rast të kundërtënieve ndërmjet neneve dhe shtojcave, nenet kanë fuqi parësore;
- (g) fjala "material" nënkupton (përveç ku ceket ndryshe), në kontekstin në të cilin përdoret, obligimin, aktin, mosveprimin, shumën, dhënien, rrethanat apo gjënë që është me rëndësi për njërën apo të dyja palët në këtë marrëveshje, apo konsiderohet nga to si e rëndësishme në kontekst të marrëveshjes së tyre për ta lidhur këtë Marrëveshje;
- (h) për qëllime të llogaritjeve sipas kësaj Marrëveshjeje, referencat në periudha kohore apo periudha prej orëve rumbullakohen në 1/10 më të afërt të një ore;
- (i) referencat në periudha kohore konsiderohen se përfundojnë në mesnatë në ditën e fundit të asaj periudhe përveç nëse nuk ceket ndryshe;
- (j) fjalët në gjininë mashkullore përfshijnë edhe gjininë femërore dhe neutrale dhe anasjelltas;
- (k) titujt dhe shënimet në këtë Marrëveshje nuk konsiderohen se janë pjesë e interpretimit apo ndërtimit të kësaj Marrëveshjeje dhe janë përfshirë vetëm për referencë më të lehtë; dhe
- (i) fjalët, frazat dhe shprehjet e përcaktuara në Shtojcën 1, pjesën 1 (përkufizimet) kanë domethënien e dhënë për to në atë Shtojcë.

Shtojca 2

Pjesa 1

Konsumatorët e privilegjuar

Sikur në datën e kësaj Marrëveshjeje, konsumatorët e privilegjuar kanë kuptimin siç definohet në Ligjin për Energji të vitit 2010, neni 19.4

Pjesa 2

Pikat e interkoneksionit

KEDS will purchase energy from KEK based on the gross electrical output of Kosovo A and Kosovo B Generating Stations less all “Auxiliary Power” consumed by each of the Generating Stations.

The electrical configuration is complex since the generating stations and electric facilities were constructed in prior times without regard for commercial arrangements; therefore, the computation of auxiliary consumption is complex, as shown in the table below:

Computation of Net Output of Kosovo A to be Sold to KEDS	
a. Net Output of the Generators excluding Auxiliary Power provided from within the generating station as measured by the following meters (KEK / KOSTT Border)	95834894
	95834896
	95834898
Auxiliary Power provided from offsite sources to the generating station as measured by the following meters:	
1. Energy delivered by KOSTT to Kosova A Substation (primarily for Auxiliary Power) measured by the following meters	95834890
	95834892
2. Energy Delivered by KOSTT at 220 and 110KV for auxiliary Power measured by the following meters	95834900
	95834888
3. Energy delivered from Kosovo A Substation to KEDS Distribution and measured by the following meters	94825069 (Fushe Kosova Substation)
	94825070 (Mazgati Substation)

<p>4. Energy Delivered to the Mine</p>	<p>94825071 (Bardhi I Madh Substation)</p> <p>94825068 (Seperacioni)</p> <p>94825072 (Mirashi)</p> <p>96256401 (Mine Office)</p>
<p>5. Energy delivered to commercial customers located in Land of Mines and Generation which is billed by KEDS as measured by the following meters</p>	<p>94825073(Kosova Thengjilli Sh.a. Ngrohtorja)</p> <p>94825067(DPQ Sh.a Kosova Thengjilli)</p> <p>4694230 (S-KEK “Metalkos” Zyre te Drejtorise)</p> <p>96256414 (Ben-Af Sh.p.k. Arben Gega)</p> <p>35720921 (EVKO, Ymer Grajqevci)</p> <p>96256448(Instituti Inkos Sh.a)</p> <p>96256260(Instituti Mjekesise se Punes sh.a)</p> <p>96256261(Instituti Mjekesise se Punes sh.a)</p> <p>31978147 (Kiosk)</p> <p>30000043 (TE DIS, I Punes Izet Rama)</p> <p>4694322 (Shoq. Humanitare Shoq.Per Lufte)</p> <p>4692997 (Kiosk Mehdi Raqi)</p> <p>96256474 (Kilo Kost-I-Kosova A)</p>
<p>b. Net Auxiliary Power provided from offsite sources = 1 + 2 – 3 – 4 - 5</p>	
<p>I. Net output of Kosovo A Purchased by KEDS = a – b</p>	

<p>Computation of Net Output of Kosovo B to be Sold to KEDS</p>	
<p>c. Net Output of the Generators excluding Auxiliary Power provided from within the generating station as measured by the following meters (KEK / KOSTT Border)</p>	<p>77049075 (A+)</p> <p>77049073 (A+)</p>

Auxiliary Power provided from offsite sources to the generating station as measured by the following meters:	
6. Energy provided to Kosovo B Power Plant for Auxiliary Power measured by the following bidirectional meters	77049075 (A-) 77049073 (A-)
7. Energy provided to Kosovo B for Auxiliary Power from Overhead line 290 measured by the following meter	77049083 (A-)
8. Energy delivered to the mine from Kosovo B measured by the following meters	97830303 97830304
9. Energy delivered to commercial customers located in Land of Mines and Generation which is billed by KEDS as measured by the following meters	4691533 (Hysen Hasan Ibrahim) 4694296 (Kiosk Myrvete Gashi) 96256473(Kilo Kost-I-Kosova B) 96257431 (Ben-Af sh.p.k. Arben Gega) 61047660 (IPKO)
d. Net Auxiliary Power provided from offsite sources = 6 + 7 – 8 - 9	
II. Net output of Kosovo B Purchased by KEDS = c - d	

The total energy to be purchased by KEDS from KEK is equal to the Net Output of Kosovo A (I above) plus the Net Output of Kosovo B (II above).